Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia totale e materialit te butë (në kg)	Çmimi për Njësi (Lekë/kg)	Çmimi total për shërbim	Afati
1.	Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier	210,153			24 (njëzet e katër) muaj
	Çmimi total				_____

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
 [*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-
se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Duke patur parasysh natyrën spitalore, është e domosdoshme dhe e rëndësishme, që materiali i butë për t'u larë, duhet të tërhiqet sa me shpejt nga pavionet ose sallat e operimit, bazuar në manualet e kujdesjeve spitalore dhe rregullave të higjienës (selektimi sipas ndotjes së materialit të butë në thasët me ngjyrë). Moslargimi në kohë i këtij materiali, do të çonte në rritjen e infeksioneve spitalore me efekt final uljen e performacës së ofrimit të shërbimit ndaj pacientëve, rritjen e ditëqendrimit, rritjen e përdorimit të medikamenteve (kryesisht antibiotikeve).

Volumi i konsiderueshem i materialit që është në përdorim në SMF, kërkon që operatori i kontraktuar, për ofrimin e këtij shërbimi, duhet të bëjë investime si në strukturën e lavanderisë, ashtu edhe në personel.

Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim, i cili do të përfshijë:

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Memorial Fier sipas grafikeve të përcaktuara, rregulloreve dhe protokolleve të higjienës dhe manualeve të kujdesit spitalor;
- Larjen e materialit të butë;
- Tharjen e materialit të butë,
- Hekuroshjen dhe paketimin e materialit të butë;
- Shpërndarjen e materialit të butë në të gjitha shërbimet dhe pavionet e Spitalit Memorial Fier, sipas grafikeve të përcaktuara;
- Shtrimin e shtratit të pacientit;

Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës prej ditës së hënë deri në ditën e diel (operatori ekonomik privat, duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavione, dhe shtrimin e shtratit të pacientit gjatë fundjavës) si dhe lenien e bazës materiale rezerve për nevojat e shërbimit gjatë shkrimeve të reja natën, urgjencave, por edhe sipas grafikut të përcaktuar për ndërrimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse, dhe sipas kërkesës së kryeinfermiereve të pavionit në rast të ndërrimit të materialit të butë kur behet i domosdoshëm për pacientë të vecantë.

Në kontratën e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë, ndër të tjera duhet të ketë disa elementë kryesorë, si:

- I. Larjen e materialeve të buta.
- II. Specifikimet Teknike të materialit të butë.
- III. Etapat e Menaxhimit të procesit të Lavanderisë.

Shërbimi në të gjithë SRMF ofrohet në numrin prej 150 shtretër. Ky është nr i shtreterve mbi të cilin llogaritet aktiviteti spitalor, si dhe pacientet hospitalizohen dhe marrin shërbimin e duhur. Gjithashtu në parashikim do të futen edhe shtreterit e mjekeve roje

Nga sa me sipër nr total i shtreterve qe duhet te pajisen me baze material dhe qe duhet te jene te mbuluar nga sherbimi i lavanderise eshte si me poshte:

Pershkrimi i Shtratit	Nr Total	Komente
Shtreter per pacientet e hospitalizuar	143	137 shtreter per pacientet e hospitalizuar + 6 shtreter per sherbimin e urgjences
Shtreterit per Mjeket Roje	7	
Totali i shtreterve	150	

Sasia e materialeve të buta për larje:

Referuar standarteve dhe protokollove për shërbimet spitalore, në vijim janë të detajuar lloji i materialit të butë që do të ketë për secilin pacient dhe që do të lahet si dhe materiali i butë për personelin mjekësor.

- *Materiali i butë i pacientit;*
 - Çarçafë
 - Batanije
 - Jorgan
 - Këllëf dysheku
 - Jastëk
 - Këllëf jastëku
 - Bizhame pacienti
 - Pantofla pacienti
 - Peshqire pacienti
- *Materiali i butë i personelit shëndetësor.*
 - Përparëse mjeku (të bardha)
 - Kostumet e Personelit Mjekësor (infermier/laborant/farmacist)
 - Kostume të ekipit (Salle)
 - Peshqirë urgjence/kabineti

Ndërrimi i shtratit të pacientit do të bëhet çdo tre ditë ose dy herë në javë, si dhe në çdo rast që kërkohet nga kryeinfermieri i pavionit/shërbimit, si pasojë e shtrimit të pacientëve të rinj (me hapjen e kartelës klinike), ose në rastet kur ndryshimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit.

Në tabelën në vijim, jepet e detajuar shpeshtësia e ndërrimit të çarçafëve, në disa prej shërbimeve të SRMF, si dhe tabela e parashikimit të larjes së batanijeve gjatë kësaj periudhe:

Nr.	Shërbimi	Shpeshësia e Ndërrimit të Çarçafëve
1	Sherbimi i Urologjise	1 x 3 ditë
2	Sherbimi I mjekesise interne (Kardiologji, Pneumologji)	1 x ditë
3	Sherbimi I kirurgjive (Kir. e Pergj. Ortopedi - Traumatologji, Kirurgji Kardio-Vaskulare, Kirurgji Torakale, Neurokirurgji).	1 x ditë për rastet e operuar
		1 x 3 ditë & për rastet para/pro operatore
4	Sherbimi Anestezi-Reanimacion	1 x ditë
5	Sherbimi i Semundjeve Infektive	1 x 3 ditë
6	Sherbimi i Neurologjise	1 x 3 ditë
7	Sherbimi i ORL+OKULISTIKE	1 x ditë të operuarit
		1 x 3 ditë & para-operacionit
8	Urgjencat	sa here te jete e nevojshme

• **Nevojat per inventar per materialin e bute *Inventar ne perdorim**

(Materiali i Bute)

Nisur nga numri total i shtreterve qe jane ne perdorim ne SRMF dhe qe jane pjese e sherbimit te lavanderise, operatori ekonomik nga momenti i lidhjes se kontrates duhet te furnizojë me bazen e meposhtme materiale te gjitha sherbimet, brenda nje afati kohor qe do te percaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu per disa nga zerat e meposhtem operatori ekonomik duhet te kete nje rezerve minimale prej 10%, per te siguruar vijueshmerine e punes mbas dites se pare te furnizimit.

Nevojat per inventar per materialin e bute.(Inventar ne perdorim).

Nr.	Emertimi	Sasia e materialit qe duhet te sjelle operatori	Sasia e materialit gjendje inventari ne SMF	Baza Materiale Rezerve.	Komente

1	Çarçaf shtrati i siperm	300		10%	15 Maj deri në 15 Shtator
2	Batanie	300		10%	
3	Bizhama pacienti	137		10%	
4	Pandofla pacienti per adultet/personeli	408		10%	Per te gjithë pacientet dhe personelin
5	Peshqire personeli/pacienti	408		10%	
6	Jasteke /kllef jasteku		450/450		
7	Klef dysheku		450	10%	
8	Jorgan		300		
9	Çarçaf		300		

Shenim: Baza materiale (,pishama..etj) eshte llogaritur vetem per shtreterit qe jane ne funksion te pacienteve, 137 shtreter .Jane perjashtuar 7shtreterit e mjekeve roje.

Së fundmi, duke pasur parasysh që personelit mjeksor do i jepen uniformat me një normë zëvendësimi sipas tabelës së mëposhtme, operatori ekonomik nga momenti i lidhjes së kontratës duhet të furnizojë me bazën e mëposhtme materiale të gjithë personelin mjeksor, brenda një afati kohor që do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor.

Gjithashtu për disa nga zerat e mëposhtem operatori ekonomik duhet të ketë një rezervë minimale prej 10% për të siguruar vijueshmërinë e punës mbas ditës së parë të furnizimit dhe në vazhdim. Sasia rezervë prej 10% duhet të jetë për secilin nga masat dhe për secilin nga zerat.

Nr.	Emërtimi	Inventari në përdorim	Sasia e materialit që duhet të sjelle	Baza Materiale Rezerve	Frekuenca e zëvendësimit	Sasia totale në vit
1	Përparëse mjeku	50	90	10%	1-vit	140
2	Perparese personeli mjeksor (infirmier, laborant, farmacist,)	100	302	10%	1-vit	402
3	Perparese sanitare	20	0	10%	1-vit	

4	Perparese, uniforma ekipi (salla)	50	10%	1-vit	
---	-----------------------------------	----	-----	-------	--

Shënim: Të dhënat e mësipërme janë referuar shkresës së Spitalit Rajonal Memorial Fier me Nr. Prot. 177/1 datë 04.06.2021, si kthim përgjigje e kërkesës së grupit të punës me Nr. Prot. 177/ date 28.05.2021.

Përzgjedhja e jorganëve me vatinë, bën të domosdoshme përdorimin e çarçafëve zarf. Një fakt i tillë, gjatë sezonit të verës, lind domosdoshmërinë e mbulimit vetëm me çarçafë. Në këto kushte, është menduar që çarçafët zarfë të përdoren për 8 (tetë) muaj, ndërsa për periudhën nga 15 Maj deri në 15 Shtator, të përdoren çarçafë të thjeshtë, pra 4 (katër) muaj, për pasojë çarçafët e poshtem për shtratin do të përdoren për 12 muaj, ndërsa çarçafët e sipërm do të përdoren për 4 muaj, ndërsa çarçafët zarf për 8 muajt e tjerë **dhe sa here te jete e nevojshme te perdoret batanija per kete periudhe.**

Po keshtu perdorimi i batanijeve eshte i nevojshem ne disa sherbime/pavione, si ne rastet postoperatore (ne dhomat e zgjimit), reanimacionet, urgjencat etj.

Cilësojmë se i gjithë materiali I bute që do të perdoret, duhet të përmbaje logon dhe emërtimin e Spitalit Rajonal Memorial Fier”.

Gjithashtu, edhe materiali i butë veshje personeli duhet të kete shenjat dalluese (logo e SRMF, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor).

- **Makinerite dhe Paisjet:**

Nisur nga kerkesat e bazes material qe SRMF ka nevoje si dhe nga sasia e larjes per dite/muaj, operatori ekonomik ne momentin e nenshkrimit te kontrates dhe fillimit te sherbimit ne SRMF ”, duhet te zoteroje makinerite e meposhtme:

Paisjet per kryerjen e sherbimit te lavanderise

Nr.	Pershkrimi	Njesia Matese	Sasia minimale
1	MAKINE LARESE PROFESIONALE(me kapacitet mbi 60 kg secila)	COPE	2
2	BARRIERA LARESE PROFESIONALE (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 60 kg secila.	COPE	1
3	MAKINE PASTRIMI KIMIK PROFESIONALE (për jorgan vatine dhe jastek, me kapacitet mbi 20 kg)	COPE	1
4	MAKINE THARESE PROFESIONALE (me kapacitet mbi 20 kg secila)	COPE	2
5	TRANSPORTUESA (KARRELA PER TRANSPORT RROBASH) PROFESIONALE (me pompa dezinfektante)	COPE	30

6	KOSHA METALIK (KARRELA PER MBAJTJE MATERIAL I BUTE) (brenda ambientit të lavanderisë, me kapacitete të ndryshme për të përballuar volumin e punës)	COPE	10
7	MAKINERI HEKUROSESE (RUL) PROFESIONAL (mbi dy metra gjatesi)	COPE	1
8	KUKULLAT HEKUROSIJE UNIFORMASH PROFESIONAL ME AVULL (per uniformat e personelit ndihmes dhe mjekeve),	COPE	1
9	MAKINA PAKETIMI PROFESIONALE PER PAKETIM INVENTARI I BUTE (me kaldaje dhe transportier)	COPE	1
10	KARROCA SHERBIMI STACIONARE PROFESIONALE NE PAVIONE (me ndarje - me kapak, të pajisur me thasë me ngjyra per vendosjen e materialeve)	COPE	10
11	ÇANTA HIGJENIKE PER TRASPORT MATERIALI BUTE (per transportin e materialeve)	COPE	50
12	POMPA DIZINFEKTANTE NE KARROCAT SHERBIMI NE PAVIONE	COPE	5
13	PESHORE ELEKTRONIKE MBI 100 KG (per peshimin e materialeve)		2

Specifikimet teknike të materialit të butë dhe struktura e nevojshme logjistike.

Referuar struktures se *SRMF*, nr te Sherbimeve, pavioneve, nr te shtrtereve etj eshte e nevojshme qe operatori duhet te kete ne strukturen e tije nje nr punonjesish si me poshte per organizimin e punes dhe realizimin e kontrates.

Nr	Pershkrimi i punes	Nr i punonjesve
1	Punetore ne Lavanderie	6
2	Pergjegjese sherbimi ne lavanteri	1
3	Punonjes sherbimi	10
4	Shofer	2
5	Puntor ngarkim-shkarkim	2
	Totali	21

Me poshte paraqiten specifikimet teknike per materialin e bute qe do te perdoret ne “SRMF”.

Materiali i butë i pacientit që do të lahet ;				
Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji I materialit
Çarçafë shtrati i poshtëm	Copë	160 – 180 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo SMF	170x270 cm	75% pambuk x 25% polyester, Lahet në temp 60°
Carçafë shtrati i sipërm	Copë	160 – 180 gr/m2 Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo SMF	160x260 cm	75% pambuk x 25% polyester, lahet në temp 60°
Çarçafë zarf	Copë	160 – 180 gr/m2 Dy fletësh, me qepje nga të tre anët, i çarë në fund për të mundësuar futjen e jorganit ne forme zarfi. Ngjyrë e bardhë. Logo SMF	190x150 cm	pambuk 100%, ngjyrë e bardhë, lahet në temp 90°
Këllëf dysheku (mbulesë)	Copë	280 - 300 gr/m2 Material pambuku, ngjyrë e bardhë, i qepur nga të katër anët me llastik për t’u fiksuar tek dysheku spitalor. Logo SMF	260x150 cm	Pambuk 100%, lahet në temp 90°

Jastëk	Copë	Mbushje uniforme me fibra sintetike. Ngjyre e bardhe, me mbulesë dyshe	50x80 cm Pesha 1000gr	Larje në te thate
Këllëf Jastëku	Copë	Nga njëra anë ka një të çarë si xhep, për të lejuar futjen e jastëkut. Ngjyrë e bardhë. 160 – 180 gr/m2. Logo SMF.	60x90 cm	75% pambuk x 25% polyester Lahet në temp 60°
Jorgan i lehtë vatine (njëngjyrë sh)	Copë	Me mbushje me vatine, me tegela ndarëse në formë kuadrati, ngjyrë e bardhë. Veshja e jashtme e jorganit të jete pambuk. Pesha 2-2.2 kg	140x180 cm	Larje në te thate
Batanije	Cope	Material 100% lesh me ngjyre sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.	Pesha 1-1-1.2 kg. Permasat 140*180cm	Larje në 40 grade.
Komplete Bizhame pacienti Adult	Cope	Pambuk I plote xhaketa me krahe të gjate, me jake ose forme V. Pantallonat unisex me llastik në bel, njëngjyreshe, Pesha 0.6-0.65 kg	Xhaketa 71 cm. Pantallona 120, +-5cm	përbërje 100% pambuku, me larje në temp 90 °.
Pandofla pacienti Adult	Copë	Lëkurë ngjyrë e bardhë, me vrima për ajrosje me shtresë ortopedike për qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Pesha 0.3-0.4 kg	Numrat nga: 37 – 43	

Peshqirë (pacienti, personeli, urgjence, kabineti)	copë	Material pambuku i butë ngjyrë e bardhë. Logo SMF. Pesha 0.15-0.2 kg	90x60 cm	pambuk 100% lahet në temp 90°
---	------	--	----------	--------------------------------------

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË TË PERSONELIT

Nr.	Emërtimi	Njësi a	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji I materialit
1	Përparëse Mjeku (Mashkull dhe Femër) unisex	copë	Material Pambuku, ngjyrë e bardhë, ku në të majtë ka një xhep të vogël të drejtë dhe do të vendoset logoja e SMF -së. Densitetin e thurjes 230 gr/m ² . Gjatësia e përparësës standarte, me mëngë të gjata, (pjesa e mbrapme me një të çarë per burrat për të lejuar lëvizjen), dhe përpara të jetë me kopsa ose me perçina, si dhe me dy xhepa pllake poshte.	Gjatësia e përparësës, sipas standartit S,M,L,XL,X XL	Pambuk 100%. Larje ne 90°
2	Kostume Infermieri (Bluzë me Pantallona)	copë	Bluza me jakë V të trashë me xhep të vogël lart majtas, ku të shënohet pozicioni dhe logoja e SMF -së. Me mëngë të shkurtra të gjëra dhe me dy xhepa anësorë poshtë bluzës. Pantallona unisex , me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme. Ngjyrat sipas	Sipas standartit S,M,L,XL,X XL Gjatësia e bluzës 71 cm, gjatësia	Përzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester, lahet në temperaturë 60°.

	unisex		kërkesës së autoritetit kontraktor. Densiteti ithurjes 130-160 gr /m ²	pantallonit standarte, tolerancë +- 2 cm.	
3	Kostume Sanitare (bluzë dhe pantallona) unisex	copë	Bluza me jakë V të trashë me xhep të vogël lart majtas, ku të shënohet pozicioni dhe logoja e SMF -së. Me mëngë të shkurtra dhe të gjëra, me dy xhepa anësorë poshtë bluzës. Pantallona unisex , me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Densiteti ithurjes 130-160 gr/m ² .	Sipas standartit S,M,L,XL,XL Gjatësia e bluzës 71 cm, gjatësia pantallonit standarte, tolerancë +- 2 cm.	Përzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester, lahet në temperaturë 60°
4	Kostume Personeli Ndihmës (bluzë dhe pantallona) unisex	copë	Bluza me jakë V të trashë me xhep të vogël lart majtas, ku të shënohet pozicioni dhe logoja e SMF -së. Me mëngë të shkurtra dhe të gjëra, me dy xhepa anësorë poshtë bluzës. Pantallona unisex , me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Densiteti ithurjes 130-160 gr/m ² .	Sipas standartit S,M,L,XL,XL Gjatësia e bluzës 71 cm, gjatësia pantallonit standarte, tolerancë +- 2 cm.	Përzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester, lahet në temperaturë 60°

5	Kostume ekipi salle jo sterilë	Copë	<p>Bluzë dhe Pantallona:</p> <p>Bluzë me jakë në formë V me mëngë të shkurtra të gjëra, me xhep lart majtas ku në palën e xhepit të shënohet pozicioni dhe logo e SMF.</p> <p>Pantallona unisex, me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme. Masat standarte M, L, XL</p> <p>Densiteti thurjes 130- 160 gr.</p> <p>Ngjyrë jeshile e errët/ blu e errët (sipas kërkesës së autoritetit kontraktor).</p>	<p>gjatësia e bluzës 71 cm, gjatësia pantallonit standarte, tolerance +- 2 cm,</p>	<p>Përzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester, lahet në temperaturë 60°.</p>
---	---------------------------------------	------	--	--	---

Shenim: Mbasi te jete lidhur kontrata me OE dhe gjate procesit te marrjes ne dorezim te bazes materiale nga SMF, do te ngrihet nje komision i cili duhet te bej peshimet e te gjithe zerave te mesiperme per te saktësuar peshen e ketyre materialeve. Ky proces duhet te behet ne prezencen e OE dhe do te firmoset nga te dyja palet. Peshat e bazes material do te perdoren ne fund te cdo muaji per llogaritjen e kg dhe faturimin mujor.

- Materialet të jenë shoqëruara me çertifikatë analize dhe me stampim logon SMF-së.
- Materialet ti përgjigjen standarteve STASH në fuqi dhe standarteve europiane CE
- Firma ofertuese duhet të plotësojë kushtin teknik paraqitjen e mostrave për çdo artikull.

Specifikimet teknike të Menaxhimit të Proçesit të Lavanderisë

Operatori ekonomik do te ofroje sherbimin e tij, nga procesi i lavanderise deri tek kompletimi me nevojat per inventarin e materialit te bute, shtrimin/nderrimin e materialeve ne shtratin e pacientit/shtratin e mjekut roje.

Sipërmarresi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larese dhe dezinfektuese, tharese, hekurose dhe paketuese, por edhe zëvendësimin e materialit të bute, nëse është i demtuar apo i amortizuar.

Operatori Ekonomik siguron nevojat per inventar per materialin e bute(inventar ne perdorim), per nje kompletim te rregullt sipas normave te shtratit qe ka SRMF, me emertimin/siglen perkatese te institucionit kontraktues. Inventari i materialit te bute, ne kuptimin e kesaj kontrate, emertimi, permasat, dimensionet, cilesia dhe normat e perdorimit ne kohe, do te perfshihen ne specifikimet perkatese.

Sipermarresi do të laje, dezinfektoje, thaje, paketoje të transportoje dhe shperndaje deri në pavion bazen e materialit të bute si dhe të beje shërbimin e plote deri tek shtrati i pacientit.

Rregullat e shtrimit të shtratit do të behen sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalore, rregullave të higjenes me njoftimin e hapjes së karteles së re të shtrimit nga K/infermieri i shërbimit si dhe sa here nevojitet nga shërbimi.

Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderise do të behet në mënyrë të përqendruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollin e higjenes, nga marrja në dorëzim të materialit të bute të papaster të ndarë sipas nendarjeve dhe zonave të rrezikshmerise (thaset me ngjyre), tek dorëzimi i materialit të bute, të lare, të hekurosur dhe të paketuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermiore. Pjesë e këtij procesi është edhe sigurimi i pastrimit të plote kimik-mekanik, në temperaturat e duhura, dhe i procesit të hekurosjes.

Larja e inventarit të materialit të bute, do të behet me këto afate:

- Carcafet, kellefet e jastekut, kellefet e dyshekut, rrobdishanet e pacientit, pizhamet e pacientit, peshqiret e pacientit, do të lahen 2(dy) here në javë, për çdo shtrim të ri, si dhe sa here të jete e nevojshme nga shërbimi.
- Jorganet e vatine, batanijet, do të lahen minimalisht 1 (një) here në vit, dhe sa here të jete e nevojshme nga shërbimi.
- Jasteket do të lahen, minimalisht 4 herë në vit dhe sa herë të jetë e nevojshme.
- Kostumet josterile të sallave të operacionit, do të behet në bazë të operacioneve që kryen shërbimi.
- Perpareset e mjekut, kostumet e personelit infermieror, personelit ndihmes, të sanitareve do të lahen 1 (një) here në javë.
- Peshqiret e personelit shëndetësor, kabinetit, do të lahen 2 (dy) here në javë, si dhe sa here të jete e nevojshme nga shërbimi.
- Pandoflat e pacientit do të lahen 1(një) here në muaj.

Ndërrimi i materialit të butë të shtratit, do të bëhet me këto afate:

- Carcafe shtrati i siperm dhe i poshtëm, carcaf zarf, kellef jasteku, kellef dysheku, peshqire pacienti, rrobdishan pacienti, pizhame pacienti, do të ndërrohen jo më pak se 2(dy) here në javë për çdo shtrat, për çdo shtrim të ri, si dhe sa here kërkohej nga shërbimi.
- Perjashtim në afatet e ndërrimit të materialit të bute të shtratit të pacientit do të bëjnë disa shërbime për shkak të specialitetit që ato trajtojnë kur shihet e arsyeshme nga shërbimi.
- Përgjegjëset e materialeve të buta, mund të ndërrojnë deri në 50 shtreter pacienti në ditë (maksimumi).

Terheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të bute në pavione, do të behet me grafik të hartuar nga Sektori i monitorimit. Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palet, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të behet me nënshkrim nga të dyja palet.

Perdorimi i inventarit të materialit të bute brenda pavionit, behet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipermarresit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas procedurave të mëposhtme:

Etapat e ketij procesi cdo dite:

- Çdo ditë, Kryeinfermieri harton forcën ditore totale per ditën e nesërme për material të butë dhe brenda orës 13:30 e dorëzon pranë Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara.
- Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore dhe ia dorëzon O.E. për zbatim.
- Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me mirëkuptim të SMF.
- Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K. konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushimit të profesionit të tij.
- Punonjësit duhet të sillen me edukatë dhe kortezi, si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të SMF.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, tu kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriat Sanitar Shëndetësor.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambjentet e lavanderisë dhe depove të materialeve të buta nëpër pavione, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit.
- Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit të infeksioneve nozokomiale, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, tharjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërisht mbrapsht në Shërbime (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me materialin e palarë për të shmangur infeksionet), deri në shtrimin e shtratit të pacientit në të gjitha shërbimet e SRMF-së:
- Operatori ekonomik siguron inventarin e materialit të butë, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka SRMF, me emërtim dhe siglën përkatëse të SRMF, për secilin artikull: dyshek spitalor, këllëf dysheku, jastëk, këllëf jastëku, batanije, çarçaf shtrati i poshtëm, çarçaf shtrati i sipërm, çarçaf zarf, jorgan vatine, pizhame pacienti, pandofla pacienti dhe personeli, kostumet e sallës, peshqirë, përparëse mjeku, kostume infermieri, sanitare, barrelambajtës, fizioterapeut, teknik laborator, teknik imazherie.
- Shpërndarja e materialit të butë në të gjithë shërbimet e SRMF-së, sipas grafikëve të përcaktuar nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara nga ora 07:00 deri në orën 15:00.
- **Procesi i marrjes në dorëzimi i inventarit në pavion, do të bëhet me dokument të rregullt të nënshkruar nga kryeinfermieri/ja i/e pavionit ose personi i autorizuar prej tij, pas numërimit, kontrollit për hekurosjen, cilësinë e materialit të butë të larë në lavanderi (në bazë të kërkesës të sjellë një ditë mëparë në sektorin e hotelerisë). Ky dokument (proçes-verbal) duhet të jetë në tre kopje, të miratuar nga "Autoriteti Kontraktor" dhe "Sipërmarrësi".**
- Shtrimi i shtratit të pacientit në pavion, si për shtrimet e reja ashtu edhe shtrimet urgjence, nga ora 15:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit të ditës së nesërme do të jete nën përgjegjësinë e personelit të SMF-se.

-
- Terheqja e materialeve te ndotura nga pavioni, do te behet nga sipermarresi deri ne oren 15:00.
 - Kontraktuesi duhet të disponojë dy mjete transporti të përshtatshme për transportin e materialeve të buta me kapacitet mbi një ton. Automjetet do të jenë të pajisura me akt kolaudimi dhe siguracion të lëshuara nga organet kompetente Shqiptare.
 - Në rast të dëmtimit / konstatimit te mungesave te materialit te bute , per periudhen e lene nen administrimin e personelit te SMF-se, do te mbahet nje proces-verbal, i cili do te firmoset nga te dyja palet, nje kopje e te cilit do te dorezohet ne sektorin e hotelerise dhe sipermarresi do te beje menjehere zevendesimet perkatese.
 - Kryeinfermieri i pavionit do të evidentojë dhe konfirmojë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimet që kryhen, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do informojë Sektorin e Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara.
 - Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevojë për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, sipërmarrësi do të proçedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë të kërkuar nga shërbimi, pas miratimit të Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara.
 - Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epindemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që vendos Drejtoria e SRMF-së.
 - Riparimi i inventarit të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet dhe përbërjen fillestare.
 - Kontraktuesi do të largojë vetë mbetjet urbane që gjenerohen gjatë ofrimit të shërbimit.
 - Sipërmarrësi siguron ujin dhe energjinë elektrike, nëpërmjet kontratave individuale me operatorët përkatës që ofrojnë furnizimin me ujë dhe energji elektrike.
 - SRMF-ja do të vendosë në përdorim ambjente, ku sipërmarrësi mund të ushtrojë aktivitetin e shërbimit të lavanderisë. Për mjedisin që do të merren në përdorim, sipërmarrësi duhet të paguajë qeranë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Keto mjedise nuk mund të tjetërsohen. Kur janë të nevojshme të bëhen përshtatje, për shkaqe teknologjike, merret miratimi me shkrim nga SRMF-ja.
 - Te gjitha kostot per ofrimin e shërbimit te lavanderise dhe hotelerise ne SMF, jane pergjegjesi dhe do te sigurohen nga vete sipermarresi.
 - Inventari i materialit te butë i shtratit të pacienteve dhe i veshjeve të personelit mjekesor janë në ngarkim të sipërmarrësit dhe administrohen nga ai deri në përfundim të kontratës së shërbimit. Me përfundimin e kontratës së shërbimit, i gjithë inventari i butë në përdorim do të tërhiqet nga OE, vetëm kur të ndërrohet i gjithë stoku fillestar (me lidhjen e kontratës së radhës).
 - Mardheniet financiare midis paleve, do te percaktohen ne momentin e lidhjes se kontrates.

Shtojca 6*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia totale e materialit te butë (në kg)
1.	Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier	210,153

TABELAT E DETAJUARA PËR SECILIN VIT**Tabela e veçantë me sasi të e vitit të parë**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia totale e materialit te butë (në kg)
1.	Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier	100,061

Tabela e veçantë me sasi të e vitit të dytë

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia totale e materialit te butë (në kg)
1.	Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier	110,092

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzetë e katër) Muaj, nga data e lidhjes së Kontratës.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

TERMAT E REFERENCES

Kryerja e Sherbimit të Lavanderisë dhe Hotelarisë në pavionet SMF

Rregullat për Qarkullimin e materialit Te Bute në pavionet e SRMF-se, për parandalimin, eliminimin e infeksioneve Spitalore.

Rregullat për eliminimin e infeksioneve spitalore, mbështeten në manualët e kujdesit spitalor, në manualët e parandalimit të infeksionit nozokomial, në rregullat e higjenes, në ligjin e inspektoriatit sanitar shtetëror, në protokollin e kujdesjeve infermierore si dhe në praktikën me të mira të spitaleve të bashkimit evropian, në shërbimin dhe kujdesin spitalor.

Pershkrimi:

Personeli i sipërmarrës, që kryen procedurat si në shtrimin e shtratit të pacientit ashtu dhe në terheqjen e materialeve të ndotura, duhet të ketë veshje identifikuese, të njohur nga autoriteti kontraktor. Ai duhet të zbatojë protokollin e kujdesit infermieror në shtrimin e shtratit të pacientit, si dhe rregullat e higjenes.

Ndarja e materialeve bëhet mbas çdo ndërrimi të shtratit, gjatë procesit të larjes apo kujdesit ndaj pacientit.

Materiali i bute duhet të manipulohet me dorëza jo sterile një përdorimshme, ai nuk duhet transportuar duke e mbajtur në dorë nga personeli apo lenë në tokë.

Mbledhja e materialeve të papastrës, do të bëhet në një vend të përcaktuar nga shërbimi, autoriteti kontraktor, në thasë identifikues me ngjyrë dhe siglen përkatëse të llojit të llojit të materialit të ndotur, të cilët do të qëndrojnë aty deri në momentin e dorëzimit.

Thasët e rrobave mbushen deri në 2/3, mbyllet krejtësisht dhe vendosen në dhomën apo vendin e parashikuar në shërbim për depozitimin e materialeve. Evakuimi duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

Thasët nuk duhet të terhiqen mbi dysheme.

Karroca e materialeve, shërben për mbajtjen e thasëve me ngjyrë, për depozitimin e materialeve të ndotura nga një shtrat në tjetrin. Karroca është e paisur me rrota dhe e ndarë me thasë specifike me ngjyrë me siglen përkatëse identifikuese.

Karroca e materialeve, nuk futet ne dhomen e te semurit. Ne momentin e nderrimit te pacientit, largo cdo objekt duke bere kujdes per aparatet dentare, auditiv, stilolaps apo tjeter material preres.

Sipermarresi terheq nga pavioni inventarin e mbyllur me thaset me ngjyra te percaktuara sipas zonave dhe normave higjeno-sanitare, per larje dezinfektim nga personi i autorizuar klinika-k/infermieri/ja, dhe ne te njejten kohe dorezon ne pavion inventarin e paster te hekurosur dhe te paketuar. Inventari qe merret ose dorezohet, eshte gjithmone i palosur dhe i paketuar.

Veshjet e punes se personelit shendetesor:

Veshjet e personelit shendetesor te ndotura, me xhepat e zbrasur vendosen ne thesin qe ndodhet tek dhoma e zhveshjes se personelit.

Rast i vecante i materialit te kontaminuar “me rrezik mikrobiologjik”:

Ky material vendoset fillimisht në një qese plastike dhe më pas në një thes rrobash të verdhë: material i kontaminuar me gjak apo lëngje biologjike.

E njëjta procedurë do të zbatohet edhe per materialin e kontaminuar (salmonela, shigela, viruse intestinale, chlostridium difficile) apo kur vihet re prania e ekto parazitëve si cimka, morra etj.

Rast i vecante i materialit te kontaminuar nga nje pacient pas ekzaminimit ne mjeksine nukleare:

Vendosni materialin e kontaminuar ne qese plastike, ruajeni ne tualetin e pacientit, lajmeroni sherbimin e radiombrojtjes (nepermjet QKU), per te kostatuar nivelin e uljes se radioaktivitetit, perpara eliminimit ne nje thes te verdhe.

Materialet e tjera do te vendosen ne thes blu, me siglen “**material i piset**”.

Qarkullimi:

Mledhja e materialit te ndotur kryehet nga nje punetor/sanitar i sherbimit cdo mengjes.

Shperndarja e materialit te paster per hospitalizim dhe veshjet e punes, behet ne cdo sherbim nga personeli i autorizuar nga sipermarresi.

Ne asnje rast materialet nuk hidhen nga sherbimet.

Përkujdesje:

Lani duart ne cdo nderrim shtrati nepermjet kesaj procedure: kryeni nje larje te thjeshte dhe me pas nje ferkim hidroalkolik te duarve, pasi te keni manipuluar me materialet e pista.

Lani cdo dite karrocet e mbajtjes se thaseve te materialit te ndotur, mos lani asnjehere materialet ne sherbim, si dhe mos merrni asnjehere material per t'a lare ne shtepi.

- Thasët e thurrur, me ngjyrat e poshtëshënuara dhe me siglën përkatëse, vendosen në një mbajtës me rrota (karrocë), dhe administrohen nga Sipërmarrësi.
- Thasët e Verdhë “**material i kontaminuar**”-vendoset çarçafët, këllëfat e jastëkut, pizham-këmishat e të sëmurëve.
- Thasët Blu- **materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.**
- Thasët Jeshilë- **material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”**
- Thasët Gri – veshjet e personelit shëndetësor ndihmës (sanitare, barrelambajtës, etj), pantallona dhe bluza.
- Thasët Vishnje (Bordeaux) – mbulesa, mbrojtëse dysheku, bluza pambuku.
- Thasët Blu – “**material i pisët**”
Shperndarja: SRMF FIER

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: SRMF FIER

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit **SSH EN 14065:2016 / UNI ENI 14065** (e vlefshme) ose ekuivalente.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet

i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
